



Implemented by
giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



PLATFORMA E PARTNERITETIT PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

TRYEZAT E KRYESUARA NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

KAPITULLI 1
“LËVIZJA E LIRË E MALLRAVE”

KAPITULLI 3
“E DREJTA E VENDOSJES DHE LIRIA PËR TË OFRUAR SHËRBIME”

KAPITULLI 20
“NDËRMARRJET DHE POLITIKAT INDUSTRIALE”

KAPITULLI 28
“MBROJTJA E KONSUMATORIT DHE SHËNDETIT PUBLIK”

Si një organizatë federale, GIZ mbështet qeverinë gjermane në përmbushjen e objektivave në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar për zhvillim të qëndrueshëm.

Publikuar nga:

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Zyrat e regjistruara

Bonn dhe Eschborn, Gjermani

Projekti “Mbështetje për Negociatat e Anëtarësimit për Kapitujt Ekonomikë të Acquis”, financuar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim dhe zbatuar nga GIZ në Shqipëri

Adresa

Rruga Ismail Qemali, Nr. 3, Kati i dytë

Tiranë, Shqipëri

T +355 4 2234365

E saneca@giz.de

Autorë:



Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA)

Blv. Gjergj Fishta, Kulla 3, Ap.2/1

Tiranë, Shqipëri

Disclaimer:

Ky publikim është hartuar në kuadër të projektit “Mbështetje për Negociatat e Anëtarësimit në Kapitujt Ekonomikë të Acquis të BE-së” - SANECA. Pikëpamjet e shprehura në të përfaqësojnë mendimin e autorit/ëve dhe nuk janë domosdoshmërisht përfaqësues të pozicionit të Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH.

Printimi: Shtypshkronja Flesh

Tiranë, Shkurt 2021

Platforma e Partneritetit për Integrimin European

Platforma e Partneritetit për Integrimin European është pjesë e strukturave negociuese të integrimit të Shqipërisë në Bashkimin European, ku realizohet informimi, konsultimi, komunikimi dhe përfshirja. Përmes saj shoqëria civile, grupet e interesit, sindikatat, rrethet akademike dhe strukturat e qeverisjes lokale bëhen pjesë e procesit të negociatave dhe japin kontributin e tyre.

Kjo platformë është ngritur nëpërmjet Urdhrit nr.113 i Kryeministrit datë 30.12.2019 “Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin European”, në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të pikës 39 të kreut IX, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 749, datë 19.12.2018, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European”.

Platforma e Partneritetit ka si qëllim:

- Rritjen e ndërgjegjësimit publik në procesin e anëtarësimit në Bashkimin European;
- Shpjegimin e procesit të anëtarësimit;
- Informimin mbi negociatat dhe progresin e bërë për çdo fazë;
- Përfaqësim gjithëpërfshirës të të gjithë partnerëve;

- Këshillim e monitorim të procesit të integrimit european nga aktorë të shoqërisë civile dhe grupe të tjera interesi.

Platforma e Partneritetit për Integrimin European përbëhet nga:

1. **Bordi drejtues** - i cili është struktura më e lartë e Platformës. Ai kryesohet nga Kryeministri dhe Ministri për Europën dhe Punët e Jashtme dhe ka në përbërje të tij 15 anëtarë, ndër të cilët: Zëvendësministri për Europën dhe Punët e Jashtme; Kryenegociatori; Drejtuesi i Sekretariatit të Integrimit European; Drejtori përgjegjës për bashkëpunimin territorial për zbatimin e projekteve IPA; Drejtori përgjegjës për koordinimin e programeve kombëtare dhe rajonale të IPA; dhe nga dy përfaqësues për këto grupe dhe institucione: shoqatat e organeve të pushtetit vendor; organizatat e shoqërisë civile; komuniteti i biznesit; shoqatat e punëmarrësve; bota akademike.

Bordi:

- a) Garanton bashkëpunimin institucional;
- b) Drejton Platformën duke garantuar mbledhjen e sugjerimeve për procesin e integrimit nga tryezat dhe miraton me shumicën e votave rregullore e brendshme të funksionimit të Platformës;
- c) Miraton raportin vjetor mbi funksionimin e Platformës

Platforma e Partneritetit për Integrimin European

2. Tryezat e Diskutimit dhe Këshillimit

- gjithsej janë 33 tryeza të cilat po ngrihen në mënyrë analoge me kapitujt e “acquis” të Bashkimit European. Tryezat kryesohen nga drejtuesit e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës (GNPIE) dhe koordinohen nga ministritë ose institucionet kryesuese të kapitujve, sipas fushës e kompetencës së tyre. Një ministri mund të drejtojë një ose më shumë kapituj pra edhe GNPIE, dhe kjo do të thotë që po aq tryeza diskutimi dhe konsultimi koordinohen nga ajo ministri.

Secila nga Tryezat e Diskutimit dhe Këshillimit ka në përbërje të saj përfaqësues të Organizatave të Shoqërisë Civile, të Pushtetit Vendor, të Komunitetit të Biznesit, Shoqatave të Punëmarrësve, Botës Akademike, Medias dhe Grupeve të Interesit.

Qëllimi kryesor i secilës tryezë është:

- a) Diskutimi, shqyrtimi dhe ndërmarrja e qëndrimeve dhe rekomandimeve drejtuar institucioneve, për procesin e integritimit europian.
- b) Këshillim në lidhje me vlerësimin e asistencës së Bashkimit European për Shqipërinë.

Kryesimi i Tryezave:

Drejtuesi i (GNPIE) për një kapitull të caktuar kryeson gjithashtu tryezën e platformës për atë kapitull. Janë krijuar

33 tryeza bazuar në 33 kapituj të Acquis që do të negociohen. Drejtuesi i GNPIE vlerëson dhe analizon situatën aktuale të kapitullit në kuadër të procesit screening dhe realizon raporte periodike. Sipas Urdhrit Nr. 94, 20.05.2019 “Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e GNPIE”, kryetar i GNPIE mund të jetë një zëvendës-ministër ose sekretar i përgjithshëm i ministrisë, drejtuesi ose sekretari i përgjithshëm i institucionit përkatës për kapitullin.

Drejtuesi i GNPIE:

- a) Është kryesuesi i Tryezës për kapitullin përkatës;
- b) Thërret dhe mbledh tryezën sipas nevojës; tryeza duhet të mbledhet të paktën një herë në muaj;
- c) Gjatë zhvillimit të tryezës mbledh konsultimet, e rekomandimet e dakordësuara drejtuar GNPIE-s përkatëse, por edhe ministrive përgjegjëse, si dhe Sekretariatit të Integritimit European e strukturave të tjera të lidhura;
- d) Vlerëson aplikimet e anëtarëve të rinj të tryezës;
- e) Në zhvillimin e tryezës fton të marrin pjesë në varësi dhe të tematikës së mbledhjes, negociatorët sipas kapitujve dhe koordinatorët e Sekretariatit të Integritimit European.

Tryezat e kryesuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 113, datë 30.08.2019 “Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin Europian” Ministria e Financave dhe Ekonomisë është institucioni drejtues i 13 kapitujve, ku përfshihen edhe:

- Kapitulli 1 - “Lëvizja e lirë e mallrave”
- Kapitulli 3 - “E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime”
- Kapitulli 20 - “Ndërmarrjet dhe politikat industriale”
- Kapitulli 28 - “Mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit publik”.

Përfshirja në tryezë:

- a) Një organizatë apo person mund të përfshihet në një ose disa tryeza në varësi të ekspertizës dhe interesit që ka.
- b) Ai ka të drejtë të informohet për mbledhjen e tryezës dhe të përfshihet duke dhënë opinione, rekomandime dhe ekspertizën e tij në kuadër të procesit të integritimit europian.
- c) Anëtar i një tryeze ka të drejtë të votojë vetëm një herë, ose të votohet nga anëtarët e tjerë për të qenë pjesë e Bordit Drejtues të Platformës së

Partneritetit nëse i përket njëres prej këtyre kategorive: shoqatat e organeve të pushtetit vendor; organizatat e shoqërisë civile; komuniteti i biznesit; shoqatat e punëmarrësve; bota akademike.

- d) Të paktën 1/3 e anëtarëve të tryezës ka të drejtë të thërrasë mbledhjen e saj duke propozuar temën apo çështjen për konsultim.

Si mund të përfshiheni në tryezë?

- Për secilën prej tryezave për të marrë pjesë fillimisht duhet realizuar një aplikim online.
- Nëse jeni përfaqësues i Organizatave të Shoqërisë Civile, Pushtetit Vendor, Komunitetit të Biznesit, Sindikatave, Botës Akademike, Medias dhe keni interesin e mjaftueshëm për të kontribuar në tryezat e diskutimit mund të dërgoni një:
 - *CV* - ku të shfaqet/demonstrohet eksperiencia juaj profesionale dhe akademike nëse aplikoni individualisht ose eksperiencia dhe ekspertiza e organizatës apo institucionit që ju përfaqësoni.
 - *Letër interesi* - ku detajohen fushat tuaja të interesit dhe mënyra se si planifikoni përfshirjen dhe kontributin në një ose disa tryeza.

Kapitulli 1

“Lëvizja e lirë e mallrave”



Lëvizja e lirë e mallrave është një nga katër liritë themelore të Bashkimit Europian. Ajo garanton qarkullimin e mallrave dhe produkteve nga një vend i BE-së në tjetrin pa tarifa doganore apo barriera të tjera. Kjo do të ndodhë edhe me produktet shqiptare kur Shqipëria të anëtarësohet në BE. Produktet do të lëvizin në të gjithë tregun europian pa asnjë kufizim, barrierë apo tarifë doganore. Për të bërë të mundur lëvizjen e lirë të mallrave Shqipëria duhet të harmonizojë rregullat teknike për sigurinë e produkteve, dhe të ngrejë infrastrukturën institucionale për të garantuar zbatimin në praktikë. (Standardizimi dhe Certifikimi, Akreditimi, Metrologjia Ligjore dhe Parapaketimet, Mbrojtja e Konsumatorit dhe Mbikëqyrja e Tregut). Me anëtarësimin në BE, për lëvizjen e mallrave Shqipëria do të bazohet në parimin e njohjes reciproke që nënkupton që çdo shtet anëtar duhet të pranojë të hyjnë në tregun e tij produktet e vendosura në mënyrë të rregullt në tregun e një shteti tjetër anëtar. Kjo do të sigurojë që konsumatorët shqiptarë do të jenë më të sigurt, pasi të gjithë produktet që do të hyjnë në Shqipëri do të jenë kontrolluar sipas standardeve europiane dhe gjithmonë do të ofrohet informacioni për secilin produkt.

Grupet me interes për tu përfshirë:

Shoqatat e komunitetit të biznesit, shoqatat e konsumatorëve, ekspertë, shoqatat dhe përfaqësues të agro-biznesit, konfindustria, bizneset prodhuese, SME, dhomat e tregtisë dhe industrisë.

Institucionet e përfshira në këtë kapitull janë:

1. Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE)
2. Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS)
3. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA)
4. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM)
5. Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT)
6. Ministria e Mjedisit dhe Turizmit (MMT)
7. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR)
8. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS)
9. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)
10. Ministria e Mbrojtjes (MM)
11. Ministria e Brendshme (MB)

Kapitulli 3

“E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime”



Është një nga katër liritë themelore të tregut të BE. Ajo garanton që çdo shtetas apo kompani nga vendet e BE-së të ofrojë shërbime në tregun e brendshëm pa pengesa, njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve profesionale dhe krijimin e një tregu të shërbimeve postare në kushtet e konkurrencës së lirë. Kapitulli ndahet në tre fusha madhore:

1) *E drejta e vendosjes dhe ofrimit të shërbimeve*
- Shqipëria duhet të përafrojë legjislacionin vendas me BE-dhe të ngrejë institucione të forta dhe kompetente që garantojnë standardet europiane. Ajo duhet të harmonizojë legjislacionin kombëtar për të hequr rregullat që pengojnë të drejtën e vendosjes apo ofrimin e shërbimeve nga qytetarët e vendeve të BE-së. Të njëjtat të drejta dhe liri do të gëzojnë edhe kompanitë dhe profesionistët shqiptarë në BE.

2) *Njohja reciproke e kualifikimeve profesionale*
- Përmes vendosjes së sistemeve të njohjes reciproke të kualifikimeve për disa profesione si doktor, dentist, infermier, veteriner, farmacist apo arkitekt diplomat dhe trajnimet do të njihen në të gjithë vendet e BE-së falë sistemit automatik european të njohjes reciproke profesionale.

3) *Shërbimet postare* - Përshtatja me rregullat e BE-së bën që shërbimet postare dhe përgjegjësitë që lidhen me to, liberalizimi i tregut dhe krijimi i një autoriteti të pavarur postar sjell ulje të kostove dhe rritje të cilësisë së shërbimeve dhe mbrojtje më të fortë të interesave të konsumatorit.

Grupet me interes për tu përfshirë:

Komuniteti i biznesit, ndërmarrjet financiare-banka, të vetë-punësuarit, ofruesit e shërbimeve, operatorët telefonikë, operatorët turistikë, profesionistë, përfaqësues të universiteteve dhe të profesioneve të lira si Mjekësia, Farmacia, Arkitektura etj., konfederatat dhe sindikatat, dhomat e tregtisë dhe industrisë.

Institucionet e përfshira në këtë kapitull janë:

1. Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE)
2. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR)
3. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR)
4. Ministria e Drejtësisë (MD)
5. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës (MIE)
6. Ministria e Kulturës (MK)
7. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS)
8. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM)
9. Autoriteti i Komunikimit Elektronik dhe Postar (AKEP)
10. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)
11. Ministria e Brendshme (MB)

Kapitulli 20

“Ndërmarrjet dhe politikat industriale”



Acquis për këtë kapitull përfshin tre grupe politikash:

1) *politikat e ndërmarrjeve*, 2) *politikat industriale* dhe 3) *masat specifike sektoriale për rritjen e konkurrencës*. Parimet e politikave në këtë kapitull synojnë të sigurojnë rregullimin strukturor, krijimin e një mjedisi më të mirë për biznesin, rritjen e investimeve të brendshme dhe të jashtme, zhvillimin e një industrie bazuar në dixhitalizim, mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME), kërkimin dhe zhvillimin, aktivitete të inovacionit dhe sipërmarrjes. Me anëtarësimin në BE, SME-të dhe sipërmarrësit shqiptarë do të kenë mundësi të përfshihen në programe të ndryshme zhvillimi dhe mbështetjeje që ofrohen nga BE. Gjithashtu do të arrihen standardet për një mjedis më miqësor për SME, më shumë mundësi financimi, si dhe zhvillim të tregjeve të reja.

Grupet me interes për tu përfshirë:

SME, shoqatat e biznesit, dhomat e tregtisë dhe industrisë, konfi-industria, HUB të biznesit e inovacionit, konfederatat dhe sindikatat, shoqatat e prodhuesve.

Institucionet e përfshira në këtë kapitull janë:

1. Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE)
2. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)
3. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR)
4. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM);
5. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR)
6. Ministria e Drejtësisë (MD)
7. Ministria e Mbrojtjes (MM)
8. Ministria e Kulturës (MK)
9. Agjencia Shqiptare e Investimeve dhe Zhvillimit (AIDA)
10. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)
11. Agjencia Kombëtare e Inovacionit dhe Kërkimit Shkencor (AKIKSH)
12. Agjencia e Prokurimit Publik (APP)
13. Autoriteti i Konkurrencës (AK)
14. Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)
15. Sekretariati i Iniciativës së Transparencës për Industrinë Nxjerrëse
16. Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS)
17. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT)
18. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD)
19. Banka e Shqipërisë (BSH)
20. Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimet Sociale (ISHPSHS)
21. Autoriteti i Komunikimeve Postare dhe Elektronike (AKEP)
22. Instituti i Statistikave (INSTAT)

Kapitulli 28

“Mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit publik”



Kapitulli mbulon dy fusha madhore:

1) *mbrojtjen e konsumatorit dhe 2) shëndetin publik.*

1) *Mbrojtja e konsumatorit* përfshin sigurinë e mallrave të konsumit, mbrojtjen e interesave ekonomike të konsumatorëve në disa sektorë specifikë si dhe informimin e konsumatorit dhe edukimin e tij, duke siguruar njëherazi rolin e organizatave të konsumatorëve. Legjislacioni i mbrojtjes së konsumatorit mban rregullat mbi produktet defektive, reklamimin e rremë, shitjet në distancë etj. Kur Shqipëria të jetë pjesë e BE, produktet e nxjerra në treg do të jenë në linjë me kërkesat e sigurisë përcaktuar sipas ligjit teknik për të mos rrezikuar shëndetin e konsumatorit. Nga ana tjetër nuk do të ketë asnjë mundësi që produkte të konsideruara të rrezikshme nga një vend i BE të shiten në vendin tonë. Gjithashtu Shqipëria do të jetë pjesë e sistemit të informimit dhe shkëmbimit të shpejtë të lajmërimeve në rastin e produkteve të rrezikshme.

2) *Shëndeti publik* mbulon fusha me rëndësi si sëmundjet e transmetueshme, organet, komponentët e gjakut, dëmtimet nga produktet e duhanit, kanceri, shëndeti mendor etj. Me anëtarësimin në BE do të përmirësohet së tepërmi shërbimi dhe politikat shëndetësore, ku dhe në Shqipëri do të jenë arritur të njëjtat standarde si për zbatimin e legjislacionit të BE ashtu

dhe për ofrimin e shërbimeve mjekësore. Në këtë drejtim cilësia e jetës për qytetarët shqiptarë do të rritet, ndërkohë që rreziku nga produktet e dëmshme do të ulet.

Grupet me interes për tu përfshirë:

Shoqatat e konsumatorëve, përfaqësues të medias, ekspertë të mjekësisë, përfaqësues nga universitetet dhe akademia, Urdhri i Mjekut, Infermierit, Farmacistit, shoqatat e biznesit, dhomat e tregtisë dhe industrisë, komuniteti i biznesit.

Institucionet e përfshira në këtë kapitull janë:

1. Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE)
2. Komisioni për Mbrojtjen e Konsumatorit (KMK)
3. Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT)
4. Banka e Shqipërisë (BSH)
5. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS)
6. Instituti i Shëndetit Publik (ISHP)
7. Spitalet Universitare për diagnostikimin, trajtimin, trajnimin e specialistëve
8. Qendra Kombëtare për Kontrollin e Gjakut
9. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor
10. Agjencia Kombëtare e Drogave dhe Pajisjeve Mjekësore



Support to Accession
Negotiations in Economic
Chapters of the Acquis

